



Suli

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ENERGJISË
DHE INDUSTRIË

DREJTORIA E PERGJITHSHME E PLANIFIKIMIT STRATEGJIK
PER MINIERAT DHE INDUSTRIE
DREJTORIA E POLITIKAVE DHE ZHVILLIMIT TE MINIERAVE

Nr. 962/

Tiranë, date 09.07.2015

Drejtuar: Z. HALIL BULICA
SHOQERIA "STUDIO PROJEKT GJEO – MIN - EN" SH.P.K
RRUGA E DURRESIT, PALLATI "BIMBASHI" NR.14

TIRANE

Për njoftim: Z. DAEL DERVISHI, DREJTOR EKZEKUTIV
AGJENCIA KOMBETARE E BURIMEVE NATYRORE
BULEVARDI "BAJRAM CURRI" BLLOKU "VASIL SHANTO"

TIRANE

Z. RRAPUSH TOLA, DREJTOR
REPARTI INSPEKTIM-SHPETIMIT TE MINIERAVE
RRUGA "LORD BAJRON", LAPRAKE

TIRANE

Lënda: Njoftim për fillim procedurash revokimi te lejes nr.1539 date 04.03.2011.

I nderuar z. Bulica,

Shoqëria "Studio Projekt Gjeo – Min – En" sh.p.k është zotëruese e lejes minerare te shfrytëzimit nr.1539 date 04.03.2011, për gëlqeror te mermerizuar, Kolosian, ne Qarkun Kukës.

Nga struktura përgjegjëse AKBN me shkresën nr. 2049 date 09.02.2015, protokolluar ne Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë (MEI) me nr.962 date 10.02.2015, është propozuar revokimi i lejes nr.1539 date 04.13.2011, , për gëlqeror te mermerizuar, Kolosian, ne Qarkun Kukës, për arsye se nuk është paguar garancia financiare për rehabilitimin e Mjedisit siç është përcaktuar ne nenin 31, pika 5 te ligjit nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë" te ndryshuar, për vitin 2011 -2012, për vitin 2012 – 2013, për vitin 2013-2014 dhe për vitin 2014-2015.

Leja juaj është dhënë sipas procedurave te përcaktuara ne Ligjin nr.7796 date 17.02.1994 "Minerar te Shqipërisë" te ndryshuar qe është shfuqizuar me ligjin nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë", te ndryshuar.

Sipas nenit 57 pika 2 dhe 3 te ligjit nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë", përcaktohet shtrirja e efekteve edhe për lejet e dhëna përpara hyrjes ne fuqi te këtij ligji.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore për revokim është i mbështetur në germen “ç” të pikës 1 të nenit 47 (neni që përcakton shkeljet ligjore për të cilat një leje revokohet) të ligjit nr.10304 date 15.07.2010 “Për sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Me shkresën tone nr.1525 date 07.03.2014, jeni njoftuar për fillimin e procedurave të revokimit të lejes nr.1539 date 04.03.2011, për gëlqeror të mermerizuar, Kolosian, në Qarkun Kukës sipas propozimit të AKBN –se, sepse në atë kohë nuk kishit paguar garancinë financiare të vitit 2011-2012 dhe për vitin 2012-2013.

Keni kërkuar me shkresën tuaj nr.17 date 25.03.2014, protokolluar në Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë (MEI) me nr.1525/1 date 27.03.2014, që të rishikohet mënyra e llogaritjes dhe vlera e garancisë financiare vjetore të rehabilitimit të mjedisit, për të cilën u është dhënë përgjigje me shkresën tone nr.1525/2 date 09.06.2014. Në përgjigje është bërë e qartë se problemi i llogaritjes së garancisë financiare vjetore, për të ardhmen, duhet ta trajtoni me AKBN, e cila është struktura përgjegjëse që e ngarkon ligji për përcaktimin e kësaj vlere.

Duke ditur problemet tuaj shëndetësore, që keni pasur kohët e fundit, procedura e revokimit ka mbetur e papërfunduar, pasi është menduar të lihet kohë për përmisimin tuaj nga ana e shëndetit dhe pas kalimit të kësaj situatë të behet shlyerja pagesave të prapambetura. Kjo situatë nuk është permisuar, por është përkeqësuar, sepse keni aktualisht 5 vite për të paguar garancinë vjetore të rehabilitimit të mjedisit, pasi që në muajin mars të këtij viti duhet të kishit paguar edhe vitin 2015 – 2016.

Sa më sipër në zbatim të nenit 48 të ligjit nr.10304 date 15.07.2010 “Për sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, **ju njoftojmë rifillimin e procedurave të revokimit të lejes nr.1539 date 04.03.2011, për gëlqeror të mermerizuar, Kolosian, në Qarkun Kukës, që shoqëria juaj zotëron.**

Ju bëjmë me dije se pas një periudhe 30 ditore nga ky rinjoftim, do të merret vendimi për revokimin e lejes nr.1539 date 04.03.2011.

Në zbatim të nenit 49 të ligjit nr.10304 date 15.07.2010 “Për sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, duhet të rehabilitoni zonën e shfrytëzimit në të cilën keni ushtruar aktivitet minerar.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin

MINISTRI

DAMIAN GJIKNORI

